



**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE,
STALLE PER
MBARESHTIMIN DHE RRITJE TE
GJETHIT/**

Person Fizik: "Kanto Kapllaj"

Nr. NIPT-i: M08621701R

**Adresa e selisë: Lagjia e Poshtme, Godinë 1 katëshe, Zona Kadastrale
1454. Nr. Pasurie 237/2, Shkrel, Malësi e Madhe, Shkodër.**

Shkoder

Janar / 2023

Tiranë, Shqipëri

Pasqyra e Lendes

Pasqyra e Lendes	3
1 Përmbledhje Ekzekutive.....	4
1.1 Baza ligjore e përmbledhjes jo teknike	4
1.1.1 Klasifikimi i raportit të VNM-së.....	Error! Bookmark not defined.
1.1.2 Lista e dokumentave për të aplikuar për procedurën e VNMsë. Error! Bookmark not defined.	
2 PËRSHKRIM I VENDNDODHJES SE OBJEKTIT	4
3 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT	9
1.1. Pershkrimi i veprimtarise:	9
3.1 Pershkrimi i instalimeve qe bejne pjese ne projekt.....	9
3.1.1 Bagetia qe do mbareshtohet	9
3.1.2 Pershkrimi i objektit	10
4 Burimet e shkarkimeve nga instalimi	12
4.1 Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes	12
4.2 Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis	12
5 Ndikime negative në Mjedis	13
6 Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme.....	14
7 Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur	15
8 Masat për parandalimin	15
8.1 Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme).....	15
8.2 Masat për përdorimin eficient të energjisë.....	15
8.3 Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, d.m.th.:.....	15
9 Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.....	16

Figura

Figura 1. Vendodhja e Subjektit	4
Figura 2. Planimetria e pjesës së stallës ku do të bëhet rritja e lopëve	7

1 Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i përmbledhjes jo-teknike është të pasqyrojë ndikimet negative dhe pozitive të projektit si dhe të përcaktojë masat që duhet të marrë subjekti për pakësimin e ndikimeve negative në mjedis dhe komunitet. Ky raport i përmbledhjes jo-teknike do të identifikojë ndikimet e mundshme në mjedis të punimeve për objektin "Stalle Per mbareshtim te imta blektorale" te subjektit "Kanto Kapllaj" sh.p.k me theks të veçantë në rekomandimet mbi zvogëlimin e ndikimit dhe marrjen e masave të nevojshme për të minimizuar ndikimet që mund të lindin gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe pas përfundimit të tij. Raporti i përmbledhjes jo teknike do të diskutojë gjithashtu mbi justifikueshmerine e projektit, alternativat e vendosjes së komponentëve të projektit të tilla si planet e projektit dhe konsideratat mjedisore. Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen gjatë dhe pas përfundimit të punimeve të propozuara.

1.1 Baza ligjore e përmbledhjes jo teknike

Legjislacioni për mjedisin ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Hartimi i raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është kërkesë e legjislacionit shqiptar dhe si i tillë ai hartohet në mbështetje të plotë me të. Parandalimin dhe shmangien e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, siguri.

1.2 Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448

Blegtoria / e. Rritje intensive e kafshëve të tjera të cilat nuk janë përmendur më lart.

2 PËRSHKRIM I VENDNDODHJES SE OBJEKTIT

Për hartimin e VNM-së është e domosdoshme njohja me projektin, qëllimin dhe objektivat e tij, vendndodhjen, teknologjinë e përdorur, infrastruktura ndihmëse, informacioni është marrë mjaft i detajuar nga **Subjekt "Kanto Kapllaj" (person fizik) dhe perfaqesuesi Z. Kanto Kapllaj** i cili ka bashkëpunuar dhe ka qenë shumë i interesuar që ky dokument të ishte sa më i plotë.



Figura 1. Vendodhja e Subjektit


Koordinatat e objektit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4


PIKA	Kordinatat GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	
	X	Y
1	461570.619	4683875.915
2	461525.819	4683826.215
3	461413.819	4683992.115
4	461386.519	4683941.715

Tabela 2. Kordinatat GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4 te subjektit

Objekti ndodhet ne Malesi e Madhe, Rrash Kullaj. SHKODER, dhe ndodhet ne Zonen Kadastrale Nr.3217, me Numur Pasurie 141/20, me sipërfaqe totale 3517 m².

2.1.1. PLANIMETRIA E INSTALIMI





SIPERFAQE= 906.8m²

(30 LOPE)
 (DHOMË MËLJË)
 (MATERNITËT)
 (DHOMË PËR VICA ME BOXE)
 (USHQIM MBI BAZE DITORE)

Gezim
 Isufaj

Digitally signed by Gezim
 Isufaj
 Date: 2022.12.14 15:28:19
 +02'00'

POBOSITËS	KANTO KAPLLAJ, MARJETA KAPLLAJ		
PROJEKTUES	ING. GEZIM ISUFAJ me Licensë K. 11833		
GRUPI PROJEKTIMIT			
Spesialitet	Enxh. Mësimi	Titulli	Titulli
konstruktor	Gezim Isufaj	K.11833	
Paqimi	Feride Xhaxhaja	A.14941	
SHprehja e PLETËS	PLANIMETRI 0.00 (MOBILIM)		
STALLI PROJEKTI			
PËRME BUSTORALE, PROGRAM QUMISHTI, MËNGJËSITËM TË VËGJËT			
SIDALLA	GRYTA	MËNGJËSITËS	PAZA
1:150	300	400	PROJEKT - 2021/08

Figura 2. Planimetria e pjesës së stallës ku do të bëhet rritja e lopëve

3 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

1.1. Pershkrimi i veprimtarise:

Kjo veprimtari ka si funksion kryesor mbareshtimin e bagetive te imeta (dhi) dhe me pas therjene tyre. Aktiviteti do te zhvillohet ne instalimin me siperfaqe prej **906 m²**.

Qellimi i veprimtarise: Kjo veprimtari ka si qellim kryesor mbareshtimin e bagetive te imeta(dhi) dhe me pas therjen e tyre. Pas therjes do te kryhet pastrimi, paketimi dhe magazinimi i produkteve nga lendet e para nga kafshet, produktet e paketuara do te magazinohen ne dhoma frigoriferike.

3.1 Pershkrimi i instalimeve qe bejne pjese ne projekt

Brenda kesaj siperfaqeje jane ndertuar gropat septike te shkarkimeve te lengeta, si dhe jane instaluar pajisjet e meposhtme:

- Kabina elektrike dhe transformatori
- Zyrat e administrates
- Ndertesa e rojes

Subjekti ka kerkuar te ushtroje aktivitetin e te imtave te llojit dhi duke i mbajtur ato ne regjim stallor. Subjekti planifikon te ketë mbi 200 krerë. Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis ka per qellim vleresimin e ndikimeve te mundshme ne mjedis te ketij lloj aktiviteti.

Stalla ku do te mbahen kafshet eshte nje object ekzistues 1 katesh qe ka patur te njejtin funksion dhe me pare. Por eshte braktisur pas viteve 90 dhe aktualisht ka nevojë per rikonstrukcion.

3.1.1 Bagetia qe do mbareshtohet

3.1.1.1 Rritja e gjedhit:

Rritja e gjedhëve është degë shumë e rëndësishme e blegtorisë, e cila njeriun e furnizon me produkte ushqimore kualitative, lëndë të para për industrinë dhe të ardhura të vazhdueshme për vetë ekonominë.

Rëndësia ekonomike e rritjes së gjedhëve bazohet në karakteristikat biologjike të gjedhëve. Ata kanë aftësi që mirë t'i shfrytëzojnë ushqimet voluminoze me kualitet më të dobët (kullosa, sana, kashta, kashtat e misrit, etj.), të cilat llojet e tjera të kafshëve i shfrytëzojnë pak ose aspak dhe mund t'i përpunojnë në produkte kualitative për ushqimin e njerëzve.

Me rritjen e gjedhëve fitohet qumështi dhe mishi, si produkte kryesore, pastaj lëkura, qimet, plehu i stallave dhe mbetjet nga industria e thertoreve (brinjët, thundrat, gjaku, etj.), si produkte sekondare, por që po ashtu kanë vlerë të lartë përdoruese. Jo rallë, në botë dhe te ne, gjedhet shfrytëzohen edhe për punë. Qumështi dhe mishi i gjedhëve përfaqësojnë produkte ushqimore që veçohen me vlera të larta ushqyese biologjike, tretshmëri të lehtë dhe përbërje të pasur të materieve ushqyese, të domosdoshme për të ushqyerit e drejtë dhe të balansuar të njerëzve. Ato përfaqësojnë burim kryesorë të proteinave (sidomos të aminoacideve esenciale), vitamina, yndyrna, materie minerale, etj.

3.1.1.2 Sistemi i rritjes „lopë – viç“:

Qëllimi kryesor i këtij sistemi është që të prodhohen viça që do të shfrytëzohen për prodhimin e mishit. Për këtë sistem sugjerohet që të shfrytëzohen lopë të racave të mishit ose lopë – meleze, që janë me produktivitet të ulët të qumështit. Ato kryqëzohen me racat për mish (më shpesh me hereford, sharole ose limuzinë). Lopët nuk milen, por i tërë qumështi shfrytëzohet nga viçat. Në kushtet tona ky sistem i rritjes kryesisht shfrytëzohet në zonat kodrinoro-malore. Si lopë – nëna, shfrytëzohen krerët e bushës, ose lopët – meleze të cilat mbarsen me dema të racës simental, montanof ose hereford. Plani i mbarsjes më mirë është të jetë i atillë që mëshjtjerrat të lindin viçat para sezonës së kullotave të bujshme. Atëherë viçat thithin qumësht dhe ndërkohë përshtaten edhe për konsumimin e kullosës. Pas përfundimit të sezonës së kullotjes, mund të vazhdohet me majmërinë e mëzerëve me racione ku dominon ushqimi i koncentruar

3.1.1.3 Dhia.

Njerëzit e shfrytëzojnë mishin, lëkurën dhe qumështin e dhisë. Nga qumështi i dhisë bëhet edhe djathëi cili është shumë i kërkuar sepse atij i atribuohen veti shëruese. Në krahasim me peshën trupore dhe sasinë e qumështit që jep dhia është kafsha që jep më shumë qumësht nga çdo kafshë tjetër. Sasia e qumështit është në kufijtë mes 1,7 deri në 2,7 litra qumësht në ditë. Nga lëkura e dhisë bëhen dorashkashumë të buta. Dhite

për ushqim nuk zgjedhin shumë i hanë të gjitha pjesët e bimëve preferojnë gjethete pemëve por edhe degët e tyre sepse sistemin tretës e kanë shumë të zhvilluar.

3.1.2 Pershkrimi i objektit

Sipërfaqja e parceles ku do ndërtohet objekti është 10707 m². Ajo ndodhet në Shkrel, Malesi e madhe, Dedaj. Sipërfaqja e gjurmës së objektit është 906.8 m², numri i kateve është një dhe nuk ka kat nën dhe.

Lartësia maksimale e objektit do të jetë 4m, nga niveli i tokës deri në kulmin me të lartë të çatise.

Përsa i përket projektimit është menduar që të studiohen hapësira për Dhite, si dhe për kecat, lopot dhe vicat. Hapsirata tjera do të jenë për veterinarinë, dhoma për mbareshtimin e dhive një lidhësi, hapësira për ushqim si dhe dhoma për mjelje.

- Hyrja për në Stalle gjithashtu është menduar të jetë po në të njëjtin vend nga një rrugë sekondare në fshat dhe si efekt i kontaktit të menjehershëm me oborrin. Hyrjet tjera në ndërtesë janë nga tre anet.
 - Objekti do të ketë një kat me funksion Stalle për mbareshtimin e bagetive, do të realizohen hapësira vetëm për Dhite dhe kecat. Do të ketë dalje dhe në pjesën anësore të objektit.
 - Objekti ka një gjatësi prej 29.55 m dhe gjatësi prej 43.15 m për të respektuar distancat nga kufiri i pronës nga të gjitha anet. Objekti është projektuar dhe në harmoni me objektet përreth tij duke u përshatur me largësitë nga rruga dhe me stilin arkitektonik të tij, pasi forma e tij vjen si rezultat i funksionit që ka. Pasi projektimi i tij bëhet për të eliminuar stresin e dhive që janë për prodhimin e qumshut.
 - Në brendësi të objektit në mobilim dhe përshatjen për mbareshtimin e bagetive dhive dhe kecat do të gjenden vendqendrimet e dhive si dhe sallat për lindjen e kecat dhe rritjen e tyre, kjo projektuar sipas normave dhe standarteve europiane për gjene e gjalle „Dhi“.
-



Objekti ka forma te pastra dhe te rregullta qe anojne drejt stilit modern, ndertesa do kete çati me pjerresi mesatare, si karakteristike e zones.

Gjithashtu eshte projektuar dhe sistemi i largimit te jashteqitjeve te bagetive qe do mbarshohen ne kete objekt stalle, perseri dhe kjo sipas normativave dhe standarteve te projektimit per kte model objekti dhe per funksionin e vecante qe ka.

Objekti ka nje sistem te paster te akseve per projektimin e tij, gjithashtu eshte perdorur sistemi akseve I cilli fillon si nga qendrat e mureve po ashtu dhe nga cepat e tyre.





4 Burimet e shkarkimeve nga instalimi

Shkarkime në ajër - Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi shkarkime, por mund të kemi çlirime të lehta nga mjetet të cilat vijnë për tu furnizuar. Komponentë të çliruar mund të citojmë CO, NO₂, SO₂. Zona në fjalë është zone urbane shumë e frekuentuar. Kështu që gjenerimi i gazeve nga mjetet do të jete në intervale të shkurtra kohe dhe mund të konsiderohet i papërfillshëm. Duhet të theksojmë edhe faktin se mjetet gjate furnizimit me lende djegëse fiken.

Shkarkime në ujëra- Ujërat e nyjave sanitare do të shkarkohen në grope septike.

Shkarkime në tokë- Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë shkarkime në tokë, mbetet të cilat do të gjenerohen si pasojë e aktivitetit të konsumit të punonjësve do të grumbullohen dhe do të depozitohen fillimisht në kontejner të mbyllur në ambientet e aktivitetit dhe në fund të çdo dite pune do të largohen për në vendet e përbashkëta të administruara nga Pushteti Vendor, ndërsa mbetje nga procesi teknologjik nuk kemi.

Gjenerimi i zhurmave- Zona e operimit ka një nivel zhurme goxha të lartë krahasuar me pika të tjera. Zhvillimi i aktivitetit mund të ndikojë në një rritje shumë të lehtë të zhurmës për mos thënë që do të jete e papërfillshme. Brenda aktivitetit nuk do të lejohet rënia e burisë.

4.1 Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes

Vendi i zhvillimit të aktivitetit disponon të gjithë kapacitetin dhe hapësirën për të operuar pa krijuar ndotje dhe shqetësime, gjithashtu theksojmë se në po të njëjtin vend subjekti ka operuar edhe më parë i pajisur me Leje Mjedis sipas ligjit në fuqi.

4.2 Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis

Shkarkimet që vijnë si pasojë e zhvillimit të aktivitetit nuk mund të konsiderohen ndotëse. Këto shkarkime do të jenë normale, brenda legjislacionit aktual në fuqi. Operatori do të marrë masa të vazhdueshme për minimizimin sa më të madh të tyre, duke bërë edhe monitorimet përkatëse për komponentët e cituar në Aneksin e mësipërme.

5 Ndikime negative në Mjedis

NDIKIME NEGATIVE NE MJEDIS
Rrezatimi Jonizues
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.
Vibracionet
Funksionimi i aktivitetit gjeneron vibrime shume te lehta vetëm ne rastet kur autobotet transportojnë lëndet djegëse, e cila ndodh vetëm ne harqe kohore te shkurtra, gjithashtu edhe ne momentin kur furnizohen mjete te renda. Këto vibrime janë shumë të lehta, nuk ndikojnë negativisht në mjedisin e zonës, shqetësimin e banoreve apo bizneseve që ndodhen në afërsi te aktivitetit.
Ndikimet në popullsi
Realizimi i projektit nuk do te këtë ndikime ne lëvizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku zhvillohet aktiviteti. Gjate funksionimit te aktivitetit nuk ka emetime në ajër, toke apo ujë te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojnë shëndetin e punonjësve apo te popullsisë se rajonit.
Ndikimet ne toke
Aktiviteti i furnizimit me naftë, benzine dhe shitja e nënprodukteve te tyre nuk gjeneron shkarkime ne toke.
Mbetjet e ngurta
Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat i aktivitetit te punonjësve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqëria dhe me pas do te dërgohen për ne vendet e caktuara nga Pushteti Vendor. Kompania do te punoje për ndarjen e tyre qe ne vendburim, nëpërmjet kontenierëve me ngjyra.
Ndikimet ne ajër
Referuar natyrës se aktivitetit mund te kemi ndikime negative ne ajër. Çlirime minimale në ajër, mund te kemi vetëm ne momentin e ndezjes se mjeteve pas furnizimit me karburant, megjithatë ne pikëpamjen mjedisore dhe shëndetësore këto ndikime mund te konsiderohen te papërfillshme.
Ndikimet ne ujera
Funksionimi i aktivitetit nuk do te këtë ndikime ne ujera.
Ndikimet ne klime
Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te përmirësimit ashtu edhe ne atë te përkeqësimit te saj. Nuk do ketë ndryshime ne temperature, ne drejtim te erës, ne sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kësaj zone.
Ndikimet ne florën dhe faunën
Zona në te cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane dhe nuk mund te analizojmë ndikime ne flore dhe faune. Operatori do te shtojë sipërfaqet e gjelbërta për një pamje vizuale me te kënaqshme për syrin dhe për te mirat ne pikëpamjen mjedisore.
Ndikimet nga zhurmat
Zona ne te cilën zhvillohet aktiviteti është një zone urbane shume e frekuentuar. Për këtë arsye zhurma është prezente ne çdo ore te ditës nga qarkullimi rrugor i makinave ashtu edhe nga ai njerëzor. Nga funksionimi I aktivitetit nuk pritet te këtë rritje te nivelit te zhurmave, aq me teper ndikime negative ne këtë prizëm.

Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rrugët lokale dhe transportin
Infrastruktura ne te gjithë perimetrin e aktivitetit është e shtruar gjithashtu edhe rruga kryesore qe kalon pranë aktivitetit. Nuk pritet qe te ketë ndikime negative apo ndryshime te infrastrukturës.
Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndërtimet, trashëgiminë arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura
Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndërtime lidhur me trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerëzore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar këtë aktivitet.
Ndikime ne rrjetin hidrografik
Natyra e aktivitetit nuk kërkon përdorim te ujit. Përdorimi i ujit qe do përdoret për nyjet sanitare do te kryhet nga rrjeti publik dhe do te shkarkohet ne rrjetin e kanalizimeve te zonës.
Ndikimi social-ekonomik
Me operimin e këtij aktiviteti pritet te ketë një impakt pozitiv ne ekonominë e vendit, ne aspektin e punësimit.

6 Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme

- Teknikat më të mira të disponueshme " (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre te veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve të përcaktuara për të parandaluar dhe ku nuk është e praktikueshme, në përgjithësi për të reduktuar emetimet dhe ndikimin i tyre në mjedis në tërësi:
- 'Teknika' përfshin te dyja si teknologjinë e përdorur dhe mënyrën në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar.
- Teknikat me te mira te disponueshme' do të thotë ato qe janë te zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomikisht dhe teknikisht te zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur
- ose prodhuar teknikat brenda territorit te Palës në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft te lejueshme për operatorin;
- Me të mirë ' do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi. Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi, ose në raste të veçanta faktorëve te mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot me të mundshme dhe përfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit:
- Proceset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qenë provuar me sukses në një shkallë industriale;
- Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të të kuptuarit;
- Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;
- Datat e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;
- Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;
- Konsumi dhe natyra e lëndëve (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë;
- Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;
- Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin. Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit te ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh te karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore

7 Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur

Aktiviteti është ekzistues dhe që në fillim ka qene në të njëjtën vendndodhje, kjo sepse është në një zone shumë të frekuentuar e cila sa vjen dhe zhvillohet me shumë. Për këtë arsye edhe fitimet ekonomike arrijnë targetin që kompania i ka vendosur vetes. Teknologjia është bashkohore dhe cilësia e hidrokarburit është e lartë, duke rritur fluksin e punës.

8 Masat për parandalimin

8.1 Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme)

- Grumbullimi i mbetjeve urbane në kontenerëve të posaçëm dhe hermetik për të evituar aromat e pakëndshme sidomos në periudhe reshesh dhe thatësire.
- Diferencimi i mbetjeve të ardhura nga aktiviteti i punonjësve që në burim në kosha me ngjyra.
- Depozitimi periodik në vendet e përbashkëta që administrohen dhe tërhiqen nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
- Mbajtja e regjistrave për sasinë e mbetjeve të gjeneruar dhe depozitimi i tyre në harqe kohore 6-mujore në instancat shtetërore përkatëse.

8.2 Masat për përdorimin eficient të energjisë

- Auditimi vjetor, nga auditues në procese për evidentimin e përdorimit eficient të energjisë.
- Kolaudimi i vazhduar i impianteve.
- Vlerësimi nga menaxheri i energjisë për gjendjen e impiantit dhe vlerësimin e pjesëve me të reja.
- Vendosja apo zëvendësimi i pajisjeve jo më vonë se 2 vjet pas përfundimeve të dala nga Audituesi i Energjisë.

8.3 Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, d.m.th.:

Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre

Detyrimet e punëdhënësit

- Punëdhënësi vetë ose personi përgjegjës që ka ngarkuar, duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:
- Specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet që do të përdoren.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës, ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajturi shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Përveç sa më sipër punëdhënësi ka detyrë që:

- Të sigurojë për çdo rast ndihmën e parë mjekësorë.
- Të vendos në territorin e instalimit, në vende të dukshme tabelat me rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Të bëjë instruktimin periodik të punonjësve dhe të plotësoj për këtë qëllim formularët bazë të përcaktuar në rregulloret e sigurimit teknik.

Detyrimet e punëmarrësit

- Të njoh mirë procesin e punës dhe makineritë apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojnë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfarë masa duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë

Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme

Natyrë e një aktiviteti të tillë nuk preket nga ndërprerje sezonale. Për këtë arsye ndërprerjet definitive do të shoqërohen me zbatimin e planit të çmontimit të instalimit dhe zbatimin e plote të planit të rehabilitimit të mjedisit post funksionim. Gjithashtu për ndërprerje të tilla si pasoje e avarive që shoqërohen me ndotje të tipeve të ndryshme duhet të njoftohen instancat shtetërore. Megjithatë aktivitetit nuk parashikon ndërprerje apo mbyllje të aktivitetit.

9 Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Qëllimet e monitorimit mjedisor Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të rregullt, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e prodhimit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga faktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar

Monitorimi i Planifikuar	
Monitorimi i parametrevë mjedisore (ajër dhe zhurme)	Çdo 6 muaj
Monitorimi i papërshkueshmërisë së depozitave	Periodik
Monitorimi i trajnimeve të stafit në raste emergjente	Çdo 6 muaj-1 vit

Monitorimi i gjendjes mekanike te pajisjeve operuese	Çdo dite nga punonjësi i impiantit Çdo 1 muaj nga mekanike te posaçëm
Monitorimi i përdorimit eficient te energjisë	Çdo 1 vit nga kompania dhe çdo 2 vjet nga Audituesi i Energjisë
